REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

BULETIN

Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Korrik 2020

1. Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Mbahet takimi i radhës i BE-së kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor

Prishtinë, 3 korrik 2020 – Anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Prokurori Zejnullah Gashi, po merr pjesë së bashku me përfaqësues të Policisë së Kosovës në takimin e tretë rajonal kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor, eveniment ky i radhës, i cili është organizuar përmes komunikimit në distancë nga Bashkimi Evropian (BE).

Qëllimi i mbajtjes së këtij takimi të rëndësishëm evropian është zbatimi i vazhdueshëm i Udhëzuesit për zgjidhje të qëndrueshme lidhur me mbajtjen e paligjshme, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024.

Në sesionet e tij po marrin pjesë përfaqësues të BE-së, Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe ministrive të punëve të brendshme të shteteve të Evropës Juglindore dhe Lindore, si

dhe përfaqësues të sistemeve të drejtësisë, të cilët kanë raportuar për zbatimin e këtij udhëzuesi në vendet e tyre.

Në këtë kontekst, anëtari i KPK-së, Zejnullah Gashi, do të raportojë para pjesëmarrësve për trajtimin nga prokuroritë e Kosovës të veprave penale të mbajtjes së paligjshme dhe trafikimit të armëve, me fokus të veçantë për rëndësinë e Mekanizmit përcjellës për veprat penale karakteristike, përfshirë këtu pashmangshëm edhe armët e vogla dhe të lehta, si dhe përshtatjen e këtij udhëzuesi me juridiksionin e shtetit të Kosovës.
Rrjedhimisht, në të gjitha sesionet e forumit deri tashti janë diskutuar progresi, sfidat dhe nevojat e vendeve pjesëmarrëse, si dhe është bërë prezantimi i planit të veprimit të këtyre vendeve që veprojnë në kuadër të këtij projekti, përfshirë përparimin në qëllimet e përcaktuara dhe nevojat e identifikuara.

Po ashtu pjesëmarrësit janë pajtuar që mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë të angazhohen fuqishëm për të siguruar një mbështetje të planifikuar për zbatimin e këtij udhërrëfyesi, të monitorojnë implementimin e gjetjeve rajonale dhe të bëjnë prezantimin e vazhdueshëm të treguesve kryesorë të performancës.

Me anë të këtij projekti, BE-ja synon të eliminojë qarkullimin e paligjshëm të armëve të kalibrit të vogël në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që krijohet një siguri më e lartë në nivelin evropian.

Shqyrtohet drafti i Rregullores për arkivat e sistemit prokuriorial

Prishtinë, 14 korrik 2020 – Në kuadër të aktiviteteve të tij, Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Zejnullah Gashi, ka analizuar draftin e Rregullores për arkivat e sistemit prokurorial të Kosovës.

Drafti ekzistues, i punuar nga grupi punues, është shqyrtuar dhe analizuar në detaje gjatë këtij takimi dhe si rezultat kanë dalë rekomandimet që do të merren parasysh në hartimin final të tij.

Kryesuesi i Komisionit, Gashi, ka falënderuar grupin punues për kontributin e tij në draftimin e kësaj rregulloreje, e cila është e një rëndësie të veçantë për funksionalizimin e punës së arkivave të sistemit prokurorial të Kosovës.

Mbahet takimi i parë i Grupit punues për hartimin e Projektstrategjisë sektoriale të sundimit të ligjit

Prishtinë, 16 korrik 2020 – Ministria e Drejtësisë ka mbajtur takimin e parë të Grupit punues për hartimin e Projektstrategjisë sektoriale të sundimit të ligjit, grup ky, i cili përbëhet nga përfaqësues të KPK-së, KGJK-së, Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave, Zyrës së Presidentit dhe Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa përveç anëtarëve të Grupit punues në takim morën pjesë edhe përfaqësues të donatorëve ndërkombëtarë, duke përfshirë Ambasadën e SHBA-së, Zyrën e BE-së, Ambasadën Britanike dhe USAID-in.

Kjo nismë reformuese e Ministrisë së Drejtësisë (MD), në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe aktorët kyç të sektorit, synon të sigurojë një vizion gjithëpërfshirës dhe të konsoliduar të sundimit të ligjit për të ngritur besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe afrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian.

Pas miratimit të rekomandimeve nga Komiteti Drejtues, të dala nga faza e dytë e këtij procesi dhe pajtimit për të filluar përpilimin e Projektstrategjisë, po ashtu, ky takim shënoi edhe hapjen e fazës së tretë dhe të fundit të procesit të Rishikimit Funksional të sektorit të sundimit të ligjit, e cila përbën hartimin e Projektstrategjisë së sundimit të ligjit.

Fillimisht, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, Qemajl Marmullakaj, njëherësh kryesues i këtij Grupi Punues, ka prezantuar para të pranishmëve përmbledhjen e shkurtër të procesit me të gjeturat dhe rekomandimet e dala nga faza e dytë.

Nga ana tjetër, Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, i cili në këtë takim ka marrë pjesë nga distanca, përmes platformës online, ka thënë se masat që synojnë rritjen e llogaridhënies dhe efikasitetin e sistemit prokurorial, avancimin e profesionalizmit të prokurorëve dhe personelit mbështetës dhe ngritjen e integritetit dhe llogaridhënies së tyre, duhet të përkrahen dhe të jenë pjesë integrale e kësaj strategjie, e cila do të jetë udhërrëfyese e rishikimit funksional.

Anëtarët e Grupit Punues u pajtuan me metodologjinë dhe hapat e mëtutjeshëm për hartimin e Projektstrategjisë sektoriale të sundimit të ligjit dhe për finalizimin e procesit të Rishikimit Funksional.

Programi për Ndihmë Humanitare i Komandës Ushtarake Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës i dhuron KPK-së një donacion me pajisje mbrojtëse kundër COVID-19

Prishtinë, 21 korrik 2020 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Bahri Hyseni, ka pranuar sot një donacion nga Programi për Ndihmë Humanitare i Komandës Ushtarake Evropiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, donacion ky, që përmban pajisje personale mbrojtëse kundër pandemisë COVID-19.

Gjatë ceremonisë së pranim-dorëzimit të këtij donacioni ishin të pranishme Shefja e Zyrës për Bashkëpunim në Mbrojtje, Majorja Courtney Olson dhe Këshilltarja e Lartë Ligjore në Zyrën për Zhvillim, Ndihmë dhe Trajnim të sistemit prokurorial në Ambasadën Amerikane në Kosovë, Lana Morton-Owens.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, ka falënderuar përfaqësuesen e Programit për Ndihmë Humanitare, Ambasadën, popullin dhe shtetin amerikan për kujdesin e veçantë dhe të përhershëm ndaj sistemit prokurorial të Kosovës, duke theksuar se kjo ndihmë e vlefshme do të ndikojë drejtpërdrejt në mbrojtjen dhe ruajtjen e shëndetit të stafit pas përhapjes së pandemisë COVID-19. "Gjithashtu, ky donacion është një tregues i mirëfilltë i bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm të KPK-së dhe Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, tha Hyseni.

Nga ana tjetër, Shefja e Zyrës për Bashkëpunim në Mbrojtje të SHBA-së, Majorja Courtney Olson, ka thënë se ndihet mirë që kanë pasur mundësi të ofrojnë këtë donacion për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe natyrisht do të ketë edhe krijohen edhe mundësi të tjera të bashkëpunimit të ndërsjellë.

KPK miraton një sërë aktesh të rëndësishme institucionale

Prishtinë, 21 korrik 2020 - Nën masat e mbrojtjes nga pandemia dhe përmes komunikimit në distancë, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi i tij, Bahri Hyseni, ka mbajtur Takimin e 183-të me radhë.

Fillimisht, anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës kanë mbajtur një minutë heshtje në nderim të jetës dhe veprës së prokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjilanit, Ismet Ukshini, i cili vdiq këtë fundjavë nga virusi COVID-19.

Pas kësaj është proceduar me rendin e rregullt të ditës, me ç'rast janë miratuar Rregullorja për administrimin e lëndëve përmes sistemit elektronik në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe Udhëzimi administrativ për menaxhimin e shpenzimit të parasë publike në sistemin prokurorial të Kosovës.

Po ashtu, KPK-ja në vijim ka miratuar edhe dy raporte:

Raportin për periudhën janar-mars 2020 të Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike dhe
Raportin për vlerësimin e performancës së dy prokurorëve me mandat fillestar, emrat e të cilëve do të dërgohen te Presidenti për dekretim të mandatit të përhershëm.
Gjatë këtij takimi janë miratuar edhe procedurat standarde për zhvillimin e hetimeve dhe ndjekjes penale të trafikimit të njerëzve, ndërsa një (1) prokurori nga Prokuroria Themelore e Ferizajt në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës iu ka vazhduar transferimi edhe për një vit, ndërsa në kuadër të katër proceseve të avancimit të prokurorëve janë avancuar prokurorët, si vijon:

Dy (2) prokurorë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin e Krimeve të Rënda të kësaj prokurorie,
Një (1) prokurore e Prokurorisë Themelore në Ferizaj nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur të kësaj prokurorie,
Një (1) prokurore e Prokurorisë Themelore në Ferizaj nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda të kësaj prokurorie dhe
Një (1) prokuror i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur të kësaj prokurorie.

Në përfundim është mbajtur një seancë dëgjimore për procedurën disiplinore ndaj një (1) prokurori të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial pritet në takim nga Ministri i Punëve të Brendshme

Prishtinë, 23 korrik 2020 - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, së bashku me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Shkelzen Çoçaj, është pritur në një takim nga Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, me ç'rast diskutuan rreth problematikave që po e përcjellin objektin e Pallatit të Drejtësisë.

Rrjedhimisht, ministri Veliu, me këtë rast informoi dy kryesuesit, se bazuar në kërkesat që janë bërë në ish-Ministrinë e Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme ka hartuar projektin për demolimin e xhamave dhe krijimin e hapjeve të dritareve në objektet e Pallatit të Drejtësisë.

Bashkëbiseduesit janë pajtuar që fillimisht të bëhen konsultimet e nevojshme dhe pas sigurimit të buxhetit të fillohet me implementimin e projektit, i cili është i nevojshëm për përmirësimin e kushteve për punonjësit e sistemit prokurorial dhe gjyqësor në këtë objekt.

Gjithashtu, gjatë këtij takimi pati diskutime edhe për fuqizimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të Këshillit Prokurorial, atij Gjyqësor dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, në kuadër të kompetencave përkatëse, si dhe për intensifikimin dhe përshpejtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me luftimin e krimit të organizuar në përgjithësi.



Diskutohet për bashkëpunimin në ndërmjetësim përmes koordinimit ndërinstitucional

Prishtinë, 16 qershor 2020 – Prishtinë, 28 korrik 2020 – Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së (SKPK), Lavdim Krasniqi, ka marrë pjesë në një takim të organizuar përmes platformës online nga UNDP-ja, ku morën pjesë edhe përfaqësuesit e Odës së Ndërmjetësuesve të Kosovës (ONK).

Qëllimi i takimi ishte gjetja e mënyrave më të lehta të bashkëpunimit me Odën e Ndërmjetësuesve të Kosovës, me qëllim të zbatimit sa më adekuat të Ligjit të ri të

ndërmjetësimit dhe avancimit të sistemit të ndërmjetësimit përmes koordinimit ndërinstitucional.

Rrjedhimisht, në këtë kontekst, Drejtori Krasniqi ka diskutuar me përfaqësuesit e Odës së Ndërmjetësuesve, e cila është themeluar përmes ligjit të ri, si dhe me përfaqësues të UNDP-së për krijimin e hapësirave për ndërmjetësim në prokuroritë e vendit, referimin e rasteve dhe administrimin e tyre, si dhe funksionimin e procesit të ndërmjetësimit gjatë pandemisë COVID 19. Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Lavdim Krasniqi, ka kërkuar nga UNDP-ja mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të stafit për ndërmjetësim në sistemin prokurorial të Kosovës.

Bashkëbiseduesit janë pajtuar që të ketë avancim dhe fuqizim të bashkëpunimit ndërinstitucional, në mënyrë që të menaxhohet rritja e numrit të rasteve, të cilat referohen për ndërmjetësim nga faktorët përkatës.

Prezantohet Raporti i Projektit SMIL për periudhën janar-qershor 2020

Prishtinë, 28 korrik 2020 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, ka marrë pjesë në një takim të organizuar përmes platformës online nga Bordi Drejtues i Projektit të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL), në të cilin morën pjesë edhe Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Skënder Çoçaj dhe drejtorët e përgjithshëm të të dy sekretariateve të këshillave.

Qëllimi i takimit ishte prezantimi dhe diskutimi i aktiviteteve, të arriturave dhe sfidave në periudhën janar-qershor 2020 në gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës.

Përfaqësuesit e Bordit Drejtues të SMIL-it kanë theksuar se ky projekt ka hasur në disa sfida për shkak të pandemisë COVID 19, veçanërisht te zhvillimi i pjesëve të ndryshme.

Megjithatë, u tha, se në këtë fazë është në proces adresimi i kërkesave nga dy Këshillat, me ç'rast pritet që ekspertët e projektit të ndërmarrin hapat e nevojshëm për realizmin e planit të punës për vitin 2020.

Me qëllim të minimizimit të ndikimit negativ të pandemisë COVID 19, menaxhuesit e SMIL-it kanë bërë rishikimin e planit të punës për periudhën e mbetur të vitit, kurse në përmbyllje të takimit, anëtarët e Bordit Drejtues të Projektit të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL) kanë thënë se do të vazhdojnë realizimin e tij më përpjekje të shtuara.



Mbahet takimi i parë i Grupit punues për hartimin e modaliteteve të reformës në sistemin e drejtësisë

Prishtinë, 29 korrik 2020 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, ka marrë pjesë sot përmes platformës online në takimin e parë të Grupit punues për hartimin e modaliteteve dhe skenarëve për çështje të reformës në sistemin e drejtësisë.

Me këtë rast, Kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, fillimisht ka përshëndetur përfaqësuesit e institucioneve pjesëmarrëse, të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e ambasadave në Kosovë, si dhe të gjithë anëtarët e tjerë të grupit punues, duke shprehur bindjen e tij se kjo nismë për reformën e sistemit të drejtësisë do të ketë sukses të plotë.

Gjithashtu, Kryesuesi Hyseni, ka mbështetur këtë proces të rëndësishëm, i cili, sipas tij, do të ndikojë në ngritjen e profesionalizmit dhe besueshmërisë në sistemin e drejtësisë.

Kryesuesi i KPK-së, Hyseni, është anëtar i këtij grupi punues, grup ky, i cili është themeluar javën e kaluar me vendimin të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të adresimit të llogaridhënies, zhvillimit të reformimit të sektorit të drejtësisë, përfshirë edhe vetingun.

Raporti gjashtëmujor financiar, temë diskutimi e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel të KPK-së

Prishtinë, 30 korrik 2020 – Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesja e tij, Prokurorja Dëshirë Jusaj, ka mbajtur sot takimin e rregullt përmes videokonferencës, në të cilin përveç anëtarëve të tij, kanë marrë pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Lavdim Krasniqi, udhëheqësit dhe stafi i njësive përkatëse të Sekretariatit të KPK-së.

Qëllimi i takimit të sotëm ishte shqyrtimi i Raportit financiar për periudhën janar-qershor 2020, me ç'rast u diskutua për mbarëvajtjen buxhetore në të gjitha nivelet e sistemit prokurorial të vendit, si dhe sfidat gjatë realizimit të tij.

Në takimin e radhës të Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel të KPK-së do të diskutohet për buxhetin pas rishikimit që do të bëhet në Kuvendin e Kosovës.

Sekretariati i KPK-së

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së

Në kuadër të përgjegjësive administrative dhe mbështetjes së Këshillit Prokurorial të Kosovës, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorive, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës ka zhvilluar takime të ndryshme, duke iu përshtatur rrethanave të krijuara nga Covid 19-shi. Ka mbikëqyrë të gjitha proceset e punëve administrative në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorin e Shtetit dhe janë autorizuar dhe realizuar veprime konkrete në mbarëvajtjen e punëve që lidhen me përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore të Sekretariatit.

Gjatë këtij muaji janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Janë koordinuar çështjet lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit të KPK-së dhe PSh-së për menaxhimin e krizave nga Covid – 19;
- Është hartuar Plani i daljes në zyrë dhe puna nga shtëpia për zyrtarët e SKPK-së;
- Është bwrw koordinimi dhe mbikëqyrw plani individual i zyrtarëve për punët nga shtëpia;
- Është bërë organizimi i mbledhjes së 183-tw të KPK-së;
- Janë mbajtur takime me përfaqësues të projekteve të ndryshme që mbështesin sistemin prokurorial të Kosovës;
- Janë koordinuar proceset e punës me tw gjitha prokuroritë;
- Janë dërguar komente lidhur me konkluzionet dhe procesverbalin e takimeve të Nwnkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri të Komisionit Evropian;
- Është ofruar mbështetje në organizimin e takimit të radhës të BE-së kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor;
- Janë ofruar përgjigje në kërkesa të ndryshme nga MIE dhe projektet mbështetëse të KPK-së;
- Janë ofruar komente në finalizimin e pyetësorit të CEPEJ-sw;
- Janë dërguar komentet sa i përket kualifikimeve të ekspertit për ofrimin e trajnimeve në kuadër të projektit të Luksemburgut;
- Është përfunduar intervista e auditimit me zyrtaren e DBF-së, sipas mostrës;
- Janë përfunduar lëndët të cilat lidhen me procesin e shpenzimit, si: plotësia, saktësia dhe autorizimi i pagesave;
- Është përfunduar trajtimi i materialit për paranë e imët, procesi i shpenzimit;
- Është përfunduar trajtimi i materialit të pranuar për faturat e pa paguara dhe raportimi i tyre;

- Është përfunduar procesi i të hyrave dhe mirëmbajtja e dokumentacionit;
- Janë trajtuar dhe përfunduar pasuritë kapitale;
- Është përfunduar materiali për pasuritë mbi 1000 euro SIMFK;
- Është përgatitur dhe dorëzuar raporti gjashtëmujor në NjQHAB, për periudhën janar-qershor 2020;
- Është përgatitur dhe dorëzuar Plani i Veprimit për Udhëheqësen e Divizionit të Buxhetit dhe Financave;
- Është përgatitur raporti i auditimit për Divizionin për Buxhet dhe Financa;
- Janë përgatitur objektivat për auditimin e Divizionit te Prokurimit;
- Janë certifikuar 492 lëndë;
- Janë pranuar 471 lëndë;
- Janë kontrolluar 466 lëndë.

Zyra për Komunikim Publik

- Ka hartuar 10 komunikata;
- Ka hartuar 1 njoftim dhe dokumente të tjera;
- Ka përgatitur monitorimin ditor;
- Ka përgatitur 2 telegrame urimi dhe 2 telegrame ngushëllimi;
- Ka përgatitur 1 reagim;
- Ka përgatitur përgjigje për media;
- Ka mbështetur organizimin e takimit të 183-të të KPK-së;
- Është koordinuar dhe mbajtur trajnimi për menaxhimin e krizave (IRZ) për zyrtarët e komunikimit publik të sistemit prokurorial;
- Është bërë dorëzimi në 5 prokurori themelore i Udhëzuesit specifik të caktimit të gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit Penal të RKS-së, donacion nga Ambasada Amerikane në Prishtinë;
- Ka lekturuar dokumente dhe materiale të ndryshme të sistemit prokurorial;
- Ka plotësuar uebportalin e ri të sistemit prokurorial të Kosovës me materiale dhe ka bërë përmirësimin, lekturimin dhe redaktimin e tyre;
- Ka bërë menaxhimin e vazhdueshëm të e-mail-it të KPK-së, ku adresohen të gjitha kërkesat e qytetarëve, mediave.

Zyra Ligjore

- Ka ofruar mbështetje për Zyrën e Kryesuesit;
- Ka ofruar mbështetje për Zyrën e Drejtorit;
- Ka ofruar mbështetje për njësitë e tjera të Sekretariatit;
- Ka draftuar vendimet e Këshillit Prokurorial;
- Ka mbështetur Komisionin për Çështje Normative;
- Ka bërë përfaqësimi gjyqësor në çështjen kontestimore ku KPK ka qënë palë e procedurave kontestimore;
- Ka trajtuar kërkesat për qasje në dokumente publike.

Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë

Ky departament ka zhvilluar aktivitete që lidhen me burimet njerëzore, prokurimin dhe administratën në sistemin prokurorial të Kosovës.

Gjatë këtij muaji janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Janë kontrolluar pushimet e stafit dhe evidentuar pushimet për prokurorw;
- Është përgatitur kujdestaria për 213 zyrtarë, 14 formularw për pagesë retroaktive, 13 formularw për ndryshime;
- Është bërë sistemimi i dokumenteve në mënyrë elektronike në E-Arkiv;
- Është bërë vendosja e përshkrimit te detyrave në formë unike për pozitat e KPK-së;
- Është bërë harmonizimi i përshkrimit të detyrave të vendeve të punës në format standarde për pozitat e stafit;
- Janë pranuar 105 shkresa dhe 506 fatura;
- Janë përkthyer 470 faqe dokumente të ndryshme dhe 2 orë përkthim simultant;
- Janë nënshkruar kontratat për projektet: Avancimi dhe mirëmbajtja e sistemit elektronik të menaxhimit te dosjeve të prokurorëve dhe Furnizimi dhe montimi i aparateve për dezinfektues për nevojat e sistemit prokurorial të Kosovës;
- Është nënshkruar kontrata për projektin: Mirëmbajtja teknike e objekteve të sistemit prokurorial të Kosovës;

Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Ky departament ka zhvilluar aktivitete që lidhen me buxhetin, financat dhe shërbimet e përgjithshme në sistemin prokurorial të Kosovës.

Gjatë këtij muaji janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Janë mbikëqyrë, menaxhuar dhe koordinuar aktivitetet kryesore për buxhet, financa dhe shërbime të përgjithshme sipas planit;
- Sipas nevojave dhe kërkesave në koordinim të vazhdueshme me administratorët janë ofruar mbështetje me qëllim të realizimit të punëve në prokurori;
- Është përgatitur Draftraporti financiar për periudhën janar-qershor 2020;
- Është përgatitur dhe dërguar në Zyrën Kombëtare të Auditimit, Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të auditimit 2019;
- Janë zotuar 444 lëndë;
- Janë shpenzuar 489 lëndë;
- Janë regjistruar 650 lëndë;
- Është mbikëqyrë, monitoruar dhe koordinuar çështja e sigurisë;

Departamenti për Teknologji Informative

Ky departament ka zhvilluar aktivitete që lidhen me teknologjinë informative në sistemin prokurorial të Kosovës.

Gjatë këtij muaji janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Është vënë në zbatim shpërndarja automatike e lëndëve në SMIL nga 13 korriku 2020, sipas planifikimit të paraparë në të gjitha prokuroritë e Kosovës përveç Prokurorisë Themelore Prishtinë;
- Është përgatitur plani i trajnimeve profesionale që duhet të ndjekin zyrtarët e TI-ve regjionale;
- Është prezantuar Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) për Prokurorinë e Apelit, duke filluar nga regjistrimi i lendeve në shkrimore si dhe veprimet që merren në zyrën e prokurorit;
- Është përgatitur Manuali i përdorimit të SMIL-it për Prokurorinë e Apelit. Po ashtu është përgatitur lista për trajnimin e stafit dhe janë njoftuar se që nga dita e hënë fillon trajnimi;

- Është prezantuar raporti i shpërndarjes në mënyrë automatike të lëndëve sipas llojit të regjistrave te prokurorwt në Prokurorinë Themelore Ferizaj, për periudhën 1 – 30 qershor 2020;
- Në bashkëpunim me stafin e teknologjisë informative Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është testuar shkëmbimi i të dhënave nga prokuroritë në gjykata dhe anasjelltas.

Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive i KPK-së

Zyra e Drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive

Në kuadër të përgjegjësive administrative dhe mbështetjes për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokuroritë e vendit, Drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë të Këshillit Prokurorial të Kosovës ka zhvilluar takime të ndryshme.

Drejtori, sipas nevojës, ka zhvilluar takime me stafin e Njësitit dhe iu ka përgjigjur kërkesave të Kryesuesit të KPK-së dhe Kryeprokurorit të Shtetit për realizimin e objektivave të ndryshme, si dhe ka realizuar takime edhe me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial

Gjatë këtij muaji ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Është mbështetur procesi i rekrutimit të prokurorëve të rinj dhe avancimit/ transferimit të prokurorëve përmes angazhimit të zyrtarit të caktuar të ZMAVP-së;
- Është mbështetur procesi i zhvillimit të formave të raporteve statistikore të SMIL-it, përmes pjesëmarrjes në takime virtuale me ekspertët ndërkombëtarë;
- Janë hartuar propozimet lidhur me dizajnimin e raporteve të SMIL-it për menaxhimin e rasteve;
- Është hartuar Raporti krahasues-analitik për mënyrën e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2019;
- Është mbështetur procesi për zhvillimin e databazës së SEMDP-së përmes takimeve të NJSHPP-së, DTI-së dhe kompanisë;
- Janë identifikuar veprimet kryesore dhe janë dhënë komentet përkatëse, të cilat kompania për avancimin e databazës SEMDP i ka propozuar për t'u zhvilluar tutje;
- Janë përgatitur informatat e kërkuara nga shoqëria civile lidhur me shënimet statistikore për performancën e përgjithshme të departamenteve të përgjithshme dhe harmonizimit të shënimeve në fund të vitit 2018 dhe fillim të vitit 2019;

- Është hartuar një raport infografik për uebportalin lidhur me veprat penale karakteristike për tremujorin e dytë 2020;
- Janë përditësuar shënimet në databazën SEMDP me të gjitha dokumentet e pranuara lidhur me dosjen personale të prokurorëve;

Zyra për Statistika

Gjatë këtij muaji ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Ka përpiluar pasqyra për ngarkesën dhe efikasitetin e prokurorëve në zgjidhjen e lëndëve nga regjistrat: PP, PPM, PPN, PPP dhe NJN, për secilin prokuror veç e veç për muajin korrik, 2020;
- Ka grumbulluar të dhëna për gjendjen e rasteve nëpër prokurori sipas regjistrave dhe departamenteve për muajin korrik;
- Ka grumbulluar të dhënat dhe ka përgatitur raportet statistikore për tremujorin e dytë dhe gjashtëmujorin e parë 2020, për veprat karakteristike;
- Ka grumbulluar të dhëna për punën e dy prokurorëve të cilët iu kanë nënshtruar procesit të vlerësimit si dhe është llogaritur % e përmbushjes së Normës Orientuese për ta.

Zyra për Trajnime

Gjatë këtij muaji ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Ka përgatitur Analizën për implementinim e Rregullores nr.01./2020 për Trajnime dhe Zhvillim Profesional në Sistemin e Prokurorial;
- Ka mbështetur organizimin dhe monitorimin e trajnimeve të organizuara për prokurorë dhe staf administrativ të sistemit prokurorial.